**SHITBLERJET***(SALES AND BUYES)*:

**ADRESA E PRONARIT DHE FIRMA**
*(ADDRESS OF OWENER AND SIGNATURE)*:

**ADRESA E POSEDUESIT DHE FIRMA**
*(ADDRESS OF POSSESSOR AND SIGNATURE)*:

**PRONARI I RI** *(NEW OWNER)*:

**SKEDUESI** *(COMPILER)*: AIDA BOJDANI

**DATA** *(DATE)*: 12/11/2003

**KOMISIONI I VLERËSIMIT** *(COMMISSION OF ASSESSMENT)*:

1.
2.
3.

**DREJTOR**
**(DIRECTOR)**

**Në bazë të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", objekti klasifikohet pasuri kulturore..**
***(According to Law 27/2018 "On Cultural Heritage and Museums", the object is cultural property.)***

**Lëvizja e objektit shoqërohet vetëm me lejen e Ministrisë së Kulturës.** ***(The movement of the object should be executed only upon the permission of the Ministry of Culture)***


**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
***REPUBLIC OF ALBANIA***
**MINISTRIA E KULTURËS**
***MINISTRY OF CULTURE***
**INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE**
***NATIONAL INSTITUTE OF CULTURAL HERITAGE REGISTRATION***


**Pronari** *(Owner)* SHTETI — *ID:* 0001
**Poseduesi***(Possessor)* DRKK VLORË — *ID:* 102


**Drejtori i IKRTK***(Director of NICHR)*
**Tel: +355(4) 22 269 03**
***Web: www.ikrtk.gov.al***


**Vula** (Seal)

## CERTIFIKATË OBJEKTI

**NUMËR** *(NUMBER)*: 30391

**VENDNDODHJA** *(LOCATION)*:

**Shteti** *(State)*: Shqipëri **Qarku** *(Region)*: Qark **Rrethi** *(District)*: Qytet

**Qytet/Fshat***(City/Country)*: Vlore **Rruga** *(Street)*: -

**FUSHA** *(DOMAIN)*: ARKITEKTURE

**KATEGORIA** *(CATEGORY)*: Objekte Kulti

**TIPI** *(TYPE)*: Manastir

**TITULLI** *(TITLE)*: Manastiri i Shën Marisë në Ardenicë

**MATERIALI** *(MATERIAL)*: Gur

**FOTOGRAFIA E OBJEKTIT 6 me 9 (cm)**
*(PHOTOGRAPHY OF OBJECT 6 by 9 cm)*

**Nr. i Regjistrit** ***(No. of Register)***:
**Nr. i Inventarit** ***(No. of Inventory)***: 1227
**KATALOGU (CATALOGUE)**
""



## TË DHËNAT KRYESORE TË OBJEKTIT
## MAJOR DATA OF THE OBJECT.

**TEKNIKA** *(TECHNIQUE):* E perzier

**KULTURA** *(CULTURE):* Bizantine

**PERIUDHA** *(PERIOD):* Mesjetë e Hershme (-)

**AUTORI** *(AUTHOR):* ANONIM ANONIM

**PËRMASAT** *(DIMENSIONS):*

**Gjatësia** *(Length)*: - **Gjërësia** *(Width)*: - **Lartësia** *(Height)*: -
**Njësia** *(Unit)*:

**PESHA** *(WEIGHT):*

**VLERA** *(VALUE):* 0 Lek

**DORËZUESI** *(DELIVERER):*

## TË DHËNA TË TJERA *(OTHER DATA):*

Kartela u hartua nga Reshat Gega ne Qershor 2003. U kontrollua nga M. Ramaliu me dt 18.01.2005.
Plotesime ne kartele:Silva Breshani
Dt:26.08.2008 (informacion,foto, plotesim i detajuar i karteles, dosja e monumenteve nga DRKK Tirane).
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve - Keshilli Kombetar i Restaurimeve
Vendim Nr. 1 dt. 23.03.2010
Vendosi:
III. Diskutimi i projekteve te financara nga donacione private:
3. Miratohet: Projekti i rikonstruksionit te çatise ne kishen e manastirin e Ardenices. Projekti miratohet me verejtjet:

## PËRSHKRIMI *(DESCRIPTION):*

Ka nje rilevim topografik, planimetri te pergjithshme, planimetri kishtare. Prerje terthore, prerje gjatesore, fasadat jashte dhe brenda, detaje ndertimore, etj. Murature guri, çati druri.Ajo perbehet nga narteksi dhe ekzonarteksi dykatesh dhe portiku ne anen jugore.Ne pasurine artistike te saj pervec veprave plastike,bejne pjese pikturat murore realizuar ne vitin 1744 nga piktoret Kostandin dhe Athanas Zografi nga Korca.Suvaja e pikturuar mbulon rreth 3 te 4 e siperfaqes e cila shtrihet ne muraturen e nderteses te perbere nga gure shtufi dhe gure te bardhe,te lidhur me llac gelqereje.Suvaja ka nje trashesi qe ndryshon nga 10-13 mm dhe perbehet nga dy shtresa.Shtresa e pare pergatitore,me trashesi 10 mm,eshte thjesht gelqere lidhur me kashte gruri,ndersa shtresa e dyte me trashesi 2-3 mm,perbehet vetem nga gelqere,mbi te cilen eshte ekzekutuar piktura.Analizat fizike te ngjyrave na kane dhene natyren inorganike te tyre:ngjyra e verdhe ka si substance baze hekurin dhe ngjyra e gjelber ka si substance baze nikelin.Ne sfondin e zi konstatohen dy shtresa,e para me ngjyre te kalter smeraldi dhe mbi te e zeza. Gjate konsolidimit te afreskeve,ne faqen perendimore,u dalluan dy faza pikturimi.Ne fazen e pare ishte pikturuar e gjithe faqja e murit,kurse ne fazen e dyte,me anen e nje lyerje te holle 5 mm,suvaja eshte shtrire mbi lyerjen e pare,pa mbuluar skenen "Fjetja e Shen Marise " dhe mbishkrimin e piktoreve qe i takonin fazes se pare.Ne faqen lindore te narteksit piktura i pershtatej konstruksionit fillestar te tij,e cila shtrihej dhe ne katin e pare.Por,me modifikimin qe peson me vone narteksi dhe hapjen e dritareve qe korrenspodojne me ato te naosit,afresket jane prere ne keto zona.Ne pergjithesi vepra e artit ruan formen e saj,por paraqet demtime si te aspektit fizik,ashtu edhe estetik.
Manastiri ka ne plan formen e nje trekendeshi me sip rreth 2500 m2. Ne qender ngrihet kisha , qe i kushtohet "Fjetjes se Shen Marise" e cila rrethohet nga konaket. . Ne qoshen verilindore ndodhet paraklisi i Shen Triadhes. Ne oborr para konakeve ndodhet pusi kryesor, ndersa stera te tjera shperndahen ne te gjithe territorin e Manastirit.. Manastiri ka gjithashtu edhe furren e bukes.
Kisha perbehet nga naosi, narteksi, prej dy galerive ose hajateve te hapura ne anen jugore dhe perendimore dhe prej kulles se kembanares qe lartesohet ne qoshen jugperendimore te kishes.
Naosi eshte i tipit bazilikal, i mbuluar me tavan druri te rrafshet. Dy rradhe ikonash druri e ndajne ate ne tre nefe. Nje ikonostas druri i gdhendur, me vlera te vecanta artistike, ndan ambjentin e altarit. Ai permbn ikona te nje cilesie te larte artistike, disa prej te cilave jane vepra te piktorit tjeter te njohur te shek. 18 Kostandin SHpataraku. Ne perpunimin e jashtem arkitektonik shquhet apsida, e p[unuar me gure gelqeror te gdhendur dhe e gjalleruar me nje harkade te verbet dhe me tulla si dhe kolonada e hajatit jugor. Ne murature jane vendosur disa fragmente reliefesh antike, mbase dhe nga Apolonia.

**RESTAURIMI:** Çdo lloj ndërhyrje; kush e ka bërë, si dhe rilevimi topologjik i objekteve të paluajtshme.

*(RESTORATION): Any kind of restoration work; the person(s) that have carried it out, as well as the topographic survey of immovable objects.*

* Tjegullat qe do te vendosen te jene me permasat e tjegullave aktuale dhe pa stampe.
* Çatia te trajtohet me tjegullat e vjetra origjinale, te cilat do te perftohen nga revizionimi. Tjegullat e vjetra te perdoren si ulluqe dhe ato te rejat te prodhuara ne menyre manuale te sherbejne si kapak.

Plotesime ne kartele:Ferdinant.Yzeiri
dt.15.04.2015

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E KULTURES,
KESHILLI KOMBETARE I RESTAURIMEVE
VENDIM
Nr.114 dt.11.11.2014

Ne mbeshtetje te nenit 28, te ligjit nr. 9048, dt.07.04.2003, "Per trashegimine Kulturore", i ndryshuar, Keshilli Kombetare i Restaurimeve, ne mbledhjen e dates 11.11.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar ne Keshillin Shkencore te Institutit te Monumenteve te Kultures,

VENDOSI:
1.Te zgjerohet "Zona e Mbrojtur e Manastir te Ardenices" ne lindje dhe perendim te monumentit
2.Ngarkohet Qendra Kombetare e Inventarizimit te Pasurive Kulturore per regjistrimin e ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike per njoftimin e tij.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.
KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

Plotesime ne kartele:Ferdinant.Yzeiri
dt.05.06.2015

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E KULTURES,
KESHILLI KOMBETARE I RESTAURIMEVE
VENDIM
Nr. 143 dt. 24.12.2014

Ne mbeshtetje te nenit 30 dhe nenit 32 te ligjit nr. 9048, date 07.04.2003, "Per Trashegimine Kulturore", i ndryshuar, Keshilli Kombetar i Restaurirmeve, ne mbledhjen e dates 24.12.201 4, pasi shqyrtoi propozimet e diskutuara me pare ne Keshillin Shkencor te Institutit te Monumenteve te Kultures,

VENDOSI:
1. Miratimin e propozimit per shpalljen Monument Kulture Kat. II (dyte), per objektin "Ish Arqipeshkvia e Durresit ne Delbnisht, Rrethi Laç, Qarku i Kurbinit".
2. Miratimin e propozimit per shpalljen Monument Kulture Kat. II (dyte), per objektin "Banesa e Abat Prend Dogit, Rubik, Rrethi Mirdite, Qarku Lezhe".
3. Miratimin e propozimit per rishpalljen Monument Kulture Kat. I ( pare) dhe Zone e Mbrojtur per "Kisha e Shen e Premtes, Lukove Sarande".
4. Miratimin e propozimit per shpallje "Zone e Mbrojtur per Manastirin e Ardenices".
5. Ngarkohet Qendra Kombetare e Inventarizimit te Pasurise Kulturore per regjistrimin e ketij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike per njoftimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.
KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

Poltesoi pasaporten:FerdinantYzeiri
dt.09.06.2015

MINISTRIA E KULTURES
MINISTRI
URDHER:
Nr.9 date,08.01.2015
- PER
,SHPALLJE ZONE TE MBROJTUR

Ne vijim te kerkeses nr.389 prot, date 3 1.12.2014 te Keshillit Kombetar te Restaurimeve konstatova se ne mbledhjen e dates 24.12.2014 Keshilli Kombetar i Restaurimeve me Vendimin nr.143, date 24.12.2014, ka shqyrtuar dokumentacionin mbi propozimet e diskutuara n& Keshillin Shkencor per shpallje zone te mbrojtur.
Nisur sa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102, paragrafi 4 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, si dhe te nenit 32 te ligjit Nr. 9048, date 07.04.2003, "Per trashegimine kulturore" i ndryshuar.

URDHEROJ:
1. Shpalljen e zones se mbrojtur per "Manastirin e Ardenices", sipas hartes bashkeiidhur.
2. Ngarkohet Qendra Kombetare e Inventarizimit te Pasurive Kulturore per regjistrimin e ketij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike prane Institutit te Monumenteve tt! Kultures "Gani Strazimiri" per njoftimin e ketij urdhri.

Ky Urdher hyn ne hqi menjehere.

MINISTRI
MIRELA KUMBARO FURXHI

**SHKALLA E DËMTIMIT** *(SCALE OF DAMAGE)*: 2

1. Shumë Mirë; ... 10. Shumë Keq *(1. Very Good; ... 10. Very Bad)*

**ORIGJINALE/KOPJE** *(ORIGINAL/COPY)*: Origjinal

**VEND ORIGJINA** *(ORIGIN PLACE)*:

**VENDI I RUAJTJES** *(STORAGE LOCATION)*:

**TRASHËGIMI** *(HERITAGE)*: **Po**

**HISTORIKU:** Ku dhe kur është zbuluar; kur ka marrë statusin e trashëgimisë kulturore.

(*HISTORIC INFORMATION*)**:** *Place and date of discovery, date of gaining the status of cultural heritage.*

Eshte shpallur monument kulture ne vitin 1948 me Dekretin nr.586, dt.17.03.1948, aprovuar me ligjin nr.609, dt.24.05.1948 dhe me Dekretin nr.4876, dt.23.09.1971. Ndodhet ne majen e kodres se emerura Karatoprak, prane fshatit Ardenice, Lushnje. Permendet qe heret ne regjistrat kishtare te Kryepeshkopates se Ohrit, 1715. Gjurmet arkeologjike ne themelet e kapeles se Shen Triadhes i takojne shek.XIV. Ekziston nje ikone e fundit te shek.XVII, e realizuar prej murg Simeon, e ketij manastiri.Ai perben nje ansambel me vlera,ne qender te se cilit ndodhet kisha Lindja e Shen Merise,e rindertuar ne vitin 1743. Piktura murale qe ndodhet ne kete kishe eshte e stilit provincial,vazhdim i tradites se vjeter pikturore te vendit tone,qe perkon me periudhen e paleologeve te shek XIV,e cila permban vlera historike dhe artistike ne kuadrin e artit tone mesjetar.Ne te ka kompozime me prirje realiste shprehje te ndjenjave individuale ne portretin e shenjtoreve,qendrime monumentale te personazheve dhe elemente origjinale realiste qe e pasurojne ate.
Manastiri i Ardenices eshte manastiri me i madhe dhe me i degjuar ne gjithe Myzeqene. Ai ngrihet ne maje te nje kodre, ne nje pozicion shume piktoresk; nga njera ane hapet nje pamje e gjere e fushes se Myzeqese, ndersa nga ana tjeter veshtrimi shtrihet deri ne detin Adriatik. Territori perreth manastirit eshte i pyllezuar me selvi dhe pisha deti. Edhe pamja nga larg eshte teper mbreselenese. Sipas nje gojedhene ketu eshte celebruar martesa e Gjergj Kastrioti, Skenderbeu ne vitin 1451.

**LËVIZJET E OBJEKTIT** *(MOVEMENTS OF OBJECT)*:

**BIBLIOGRAFIA** *(BIBLIOGRAPHY)*:

Pirro Thomo, Kishat Pasbizantine ne Shqiperine e Jugut, Kap.II, Myzeqeja.
Monumentet 2/1986.Monumentet 2/1988
Restaurimi i Monumenteve te Kishes Orthodokse ne Shqiperi.